KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK
MUNICIPALITY JUNIK

STRATEGJIA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

2024-2026

JUNIK 2024

SHKURTESAT

IT	Teknologji e Informacionit
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal
SWOT	Strengths-Weaknesses-Opportunities-Threats
TEAM	Transparent, Effective and Accountable Municipalities
ZKI	Zyra për Koordinim dhe Informim

PËRMBAJTJA

1. ...
2. HYRJE ... 4
3.2. Administrata Komunale ... 5
3.3. Zyrtari për Informim Publik ... 6
3.4. Komisioni Dëgjimor ... 6
4. GJENDJA AKTUALE ME INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN ... 7
4.1 Komunikimi i brendshëm ... 8
4.2. Infrastruktura ... 8
4.3. Komunikimet online dhe platformat sociale ... 8
4.4 Transparenca dhe qasshmëria e informatave të rëndësishme ... 8
4.5. Pyetësori dhe diskutimet fokusuese ... 9
4.6 Vlerësim vetjak - Analiza SWOT ... 10
5. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM ... 10
6. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT ... 11
1. *Avancimi i praktikave të komunikimit ndërveprues për administratën komunale* ... 12
2. *Rritja e cilësisë në përgatitjen, harmonizimin dhe agregimin e informatave* ... 13
7. KANALET E KOMUNIKIMIT ... 13
8. AUDIENCAT, MESAZHET DHE MJETET E DESHIRUARA ... 14
9. INTERVENIMET NË SHKANDOHATE KOMUNIKIMI ... 15
10. MJETET PROMOVUESE PËR VITIN 2024 ... 18
11. PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI ... 21
12. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË ... 21
13. SHTOJCAT ... 22
Shtojca 1. Plani i Veprimit për Komunikim, Informim dhe Edukimin e Qytetarit ... 23
Shtojca 2. Plani i Veprimit për Transparencën 2023-2026 ... 23

1.

2. HYRJE

Komuna e Junikut në vazhdimësi është përpjekur që t'i përmirësojë dhe avancojë mekanizmat e vet të komunikimit me audiencat e shumta me synimin që t'u përgjigjet dinamikave të reja teknike dhe teknologjike dhe nevojave e kërkesave të qytetarëve për shërbime cilësore, dhe informim të saktë e të kohshëm.

Qëllimi i hartimit të kësaj strategjie për informim dhe komunikim ka synim përmirësimin e komunikimit me qytetarë, të rritë transparencën e veprimtarisë së Komunës, të rritë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarje, të avancojë marrëdhëniet me mediat dhe të vendosë një sistem efikas të komunikimit të brendshëm, duke krijuar komunikime të strukturuara në mënyrë që mekanizmat komunikues në jetë ellisin të përshtatshëm e të qëndrueshëm dhe si të tillë të mbështesin përmbushjen e misionit të komunës për një shoqëri të hapur që promovon diversitetin dhe shkëmbimin e mendimeve, duke i respektuar mendimet e të tjerëve.

Në vazhdën e kësaj përpjekjeve, është hartuar Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026 si një dokument i rëndësishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë. Ky plan u miratua nga Kuvendi i Komunës, në seancën e muajit shkurt 2023.

Strategjia për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2024-2026 është e përqendruar në rritjen e aftësisë të komunikimit dhe informacionit në komunën e Junikut kështu audiencave të synuara dhe përcjellon orientimet e administratës komunale për informim të kohshëm e transparentë qeverisës, komunikim etikan, marrëdhënie të shëndoshë me median dhe pjesëmarrje të qytetarëve në procesin vendimmarrës.

Përmes kësj Strategjie do të kërkohet një reagim pro-aktiv i audiencave tuaj parës, aktiviteteve dhe projekteve të komunës, e për rrjedhojë edhe fuqizim të marrëdhënieve dhe ndërveprimit me qytetarë, media, organizata të shoqërisë civile, biseda dhe partnerë që mbështesin nismat e komunës. Përveç kësj Strategjie është e një rëndësie të veçantë si për krijimin e urave të ndërveprimit me aktorë të ndryshëm ashtu edhe për ngritjen e imazhit dhe reputacionit të Komunës.

Një strategji efikase e informimit dhe marrëdhënieve me publikun mbështetet fuqi në komunikimin dhe rolin aktiv të të gjitë të punësuarve në administratën dhe institucionet komunale. Për këto arsye, pjesë integrale e kësaj strategjie është edhe komunikimi i brendshëm si një komponentë që ekskluzivisht përqendrohet në përmirësimin e praktikave të komunikimit dhe rritjen e motivimit të të punësuarve në përmbësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Bashkëpunimi, bashkëvendimi dhe komunikimi efikas (si brenda drejtorive të caktuara ashtu edhe ndërmjet tyre) si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve dhe marrëdhënieve në punë përbëjnë parakushtet themelore për rritjen e motivimit dhe performancës në punë.

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zbatimin e objektivave të kësaj strategjie, Komuna do të krijojë mundësi optimale për ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të zyrtarëve për

informim. Kurse në rastet të veçanta do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm me qëllim të avancimit të nivelit të komunikimeve në administratën komunale.

3. SFONDI

3.1. Profili i Komunës

Komuna e Junikut ka prejtë të përshtatshme gjeografike para grykës pitoreske të lumit Lumbi. Lartësia mbidetare e Junikut shkon nga 450 deri në 800 metra mbi nivelin e detit. Vet qyteti i Junikut, gjendet në lartësi mbidetare 593 m. Maja me e larte është Gjeravica, me lartësi mbidetare 2656 m e cila është gjithashtu edhe pika më e lartë në Kosovë e Alpeve Shqiptare

Juniku ndodhet në gjysën perëndimore të Kosovës, pranë Alpeve Shqiptare. Ka territor me sipërfaqe proj. 77.37 km² dhe shtrihet në gjerësi gjeografike proj 42° e 22' dhe gatësi gjeografike proj 20°26'.

Territori i Komunës së Junikut shtrihet deri në veri-perëndim të fushës të Dukagjinit, dhe kufizohet me Komunën e Decanit, Komunën e Gjakovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Malit të Zi. Komunave Junikut, përveç qytetit të Junikut, përbehet edhe nga dy fshatra: Jasiq dhe Gjocaj të braktisura në pjesë të madhe

Junikun e shtrin i rrethuar nga vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna të cilat ofrojnë mundësi ideale për zhvillimin e turizmit malor.

Afërsia me rajonin La ltësë të mundur që Junikut të jetë i pasur në pllenin e biodiversitetit. Biodiversiteti reflekton shumëllojshmërinë e qenieve të gjalla varësisht se në cilën zonë zhvillohen. Ky koncept përmbledh gjithashtu larmanin brenda llojit, ndërmjet llojeve dhe ndërmjet ekosistemeve relaborim më i gjere është bërë në kapitullin e biodiversitetit.

Juniku ka klimë kontinentale, por, me disa tipare mesdheare. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqesore. Mesatarja e temperaturës është 9.1° C në verë dhe -1.1° C në dimër. Sasia mesatare e reshurave është afër 670 mm², kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm².

Sipas regjistrimit të vitit 2011 numri i popullsi është 6064 banor, shkruhohet se 51% janë nën moshën 26 vjeçare.

3.2. Administrata komunale

Administrata Komunale është e organizuar në 7 drejtori: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim, dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Në kuadër të administratës, më sakësisht në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, funksionojnë edhe njësi më të vogla organizative, si: *Zyra e Personelit, Zyra e Auditimit të Brendshëm, Zyra e Prokurorisë, Zyra për Integrime Evropiane dhe për Komunitetet dhe Këshilli i dhe Zyra për Barazi Gjinore.*

Misioni i Komunës:

Misioni i komunës është që të arrihet autonomia lokale dhe të forcohet qëndrimi e komunës që mbrojnë përfaqësimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive dhe të përgjegjshme, për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe zhvillimin lokale.

3.3. Zyra për Informim Publik

Zyra për Informim Publik, vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës, duke siguruar kështu informim të vazhdueshëm për të gjitha qytetarët e Komunës dhe më gjerë. Përbëhet nga Zyrtari për Informim dhe Zyrtari për Marrëdhënie me Publikun.

Zyra për Komunikim me Publikun (ZKP) kujdeset për transparencën e punës së institucionit kundrejt publikut dhe siguron pasqyrimin e drejtë dhe të saktë të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, drejtorive dhe njësive tjera të ekzekutivit.

Në kuadër të funksioneve të saj, siguron transparencë dhe qasje publike për punën e drejtorëve komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale; duke u ofruar informata dhe dokumente qytetarëve dhe medieve, si dhe koordinon organizimin dhe zhvillimin e takimeve me karakter informues apo të ndërgjegjësimit.

Po ashtu, ZKP mirëmban uebfaqen e Komunës dhe llogaritë në platformat e komunikimit social; duke publikuar të gjitha njoftimet për mbledhjet, informatat nga takimet e kryesisë të Komunës, Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, planet dhe raportet e Kuvendit të Komunës, si dhe koordinon publikimin e shpalljeve, konkurseve dhe renderëve si dhe të gjitha informatat dhe publikimet tjera me rëndësi për qytetarët dhe opinionin e gjerë.

Vetëm i Komunës së Junikut të cenuar me injorimin dhe komunikimin e shtë të keq qytetarë te informuar, me mekanizma efikasë të komunikimit dhe të pjesëmarrjes, duke e bërë kështu Komunën e Junikut të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të saj.

Përmes kësaj strategjie qytetarët e komunës do të jenë informuar për zhvillimet komunale, për procesel e vendim marrjes në qëllim të rritjes së nivelit të transparencës para qytetarëve dhe institucioneve të tjera relevante.

3.4. Korniza Ligjore

Hartimi i kësaj Strategjie është i mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës, Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si dhe rregulloreve dhe udhëzimeve administrative që ndërlidhen me informimin e publikut, transparencën e komunave dhe krijimin e mekanizmave për përfshirjen të drejtë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen komunale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës - bazohet në parimet e qeverisjes së mirë: transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 - obligon kuvendet e komunave që të miratojnë rregullore të posaçme për transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës.

Statuti i Komunës së Junikut – përcakton parimet e përgjithshme të informimit të qytetarëve mbi vendimet dhe aktivitetet e komunës; komunikimi me qytetarë me qëllim të marrjes së rekomandimeve të tyre mbi dokumentet me interes të përgjithshëm; dhe mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitete dhe procese të vendimmarrjes për dokumente të interesit të përgjithshëm sikurse janë buxheti, rregulloret, dokumentet strategjike etj.

Rregullorja për transparencë – përcakton obligimet dhe përgjegjësitë e Komunës së Junikut dhe të zyrtarëve komunal për informim, komunikim dhe pjesëmarrje të qytetarëve në aktivitetet dhe në procesin e vendimmarrjes në komunë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215 - garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo bazë, për të pasur qasje pas kërkesës në dokumentet e mbajtura, të hartuara, apo të pranuara nga institucionet publike.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna – përcakton rregullat, parimet, formatet, procedurat dhe standardet minimale të konsultimit publik në komuna me qëllim e zbatimit të politikave, rregulloreve dhe aktiveve ndërligjore të komunës.

Udhëzimi Administrativ nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna - ka për qëllim forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative komunale, rritjen e

pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivelin lokal dhe këshillimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunës.

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2013 për Web-Faqet e Institucioneve Publike - është dokumenti që përcaktoi standardet, formën, dukjen dhe karakteristikat tjera që duhet të kenë të gjitha web-faqet e institucioneve publike, duke përshirë edhe ato të komunave.

4. GJENDJA AKTUALE ME INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN

4.1. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi brenda për brenda administratës komunale ka avancuar organizimin e shërbimeve dhe përbën një shtysë të fortë që ka mbështetur komunikimin e fashtëm, për edhe ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e praktikave të punës dhe motivimin e personelit për të performuar me sukses dinamikat në rritje të qeverisjes lokale. Pavarësisht nga kjo, ka hapësirë për përmirësime në mënyrë që të sigurohet një komunikim edhe më efikas në të gjitha drejtimet.

Synimi i planifikimit të komunikimit të brendshëm përmes kësaj Strategjie është që të mundësojë qasje të mjaftueshme të personelit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të dëshërdishme dhe punojë e udhëzime nga menaxhmenti dhe operoi *komunikim njëkah-pesëkah*, shkëmbimi ndër-sektorial *komunikim i ndërmjetëm* dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon diçgjitimin e zërit të secilit *brenda institucionit*.

4.2. Informimi

Synimi primar i komunës mbetet informimi i qytetarëve mbi punën e organeve të saj. Angazhimi i kryetarit të komunës, i kuvendit të komunës, i drejtorive dhe segmenteve tjera të komunës në vazhdimësi synohet që të përmbushet qytetarëve përmes informimit të shpejtë dhe të saktë. Publikimi me kohë i vendimeve të kryetarit të komunës, i vendimeve të kuvendit të komunës, i raporteve të punës së drejtorive të komunës me theks të veçantë i raporteve periodike financiare mbetet synim i përhershëm i komunës. Komuna e Junikut përmes përmbushjes së obligimeve ligjore për informim të qytetarëve për edhe realizimin të aktiviteteve tjera të vitit i tejkalojnë kërkesat e dala nga legjislacioni, synon që të paraqesë një praqyrë të plotë dhe të saktë mbi punën dhe angazhimin e organeve komunale.

Përmes një informimi të drejtë dhe me kohë të qytetarëve mbi punën e komunës hapen mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dhe partneritetit të Komunës së Junikut me qytetarë e saj. Kjo me të mundëson vendosjen e komunikimit të rregullt të komunës dhe qytetarëve dhe lehtëson pjesëmarrjen e qytetarëve në aktivitetet e komunës.

4.3. Komunikimet online dhe platformat sociale

Burim kryesor i informatës është ueb faqja zyrtare e Komunës, i cili ofron udhëzues të shumtë mbi strukturën organizative të komunës, shërbimet e ofruara, buxhetin dhe financat, aktivitetet e prokurimit, vendimet e marra nga kryetari dhe kuvendi i komunës dhe shumë e shumë informacione me interes publik dhe në funksion të llogaridhënies dhe transparencës.

Funksionimi dhe administrimi i ueb-sajteve të komunave është i rregulluar me *Udhëzimin Administrativ të MAP Nr. 01/2015 mbi web-faqet e institucioneve Publike*. Në vitin 2018 është përmirësuar një shumë për ri-dizajnimin e tyre, e cila kishte për qëllim integrimin e sistemit të informacit në menaxhimin e ueb-faqeve, e për rrjedhojë edhe avancimin e shërbimeve online, zgjerimin e shumës të aplikacioneve dhe transmetimin direkt të seancave të Kuvendit. Komuna përgjatë dy viteve të fundit ka bërë shumë përpjekje që të sigurojë publikimin e të gjitha dokumenteve me rendësi që ueb-sajtin e komunës. Një punë shumë e vlershme është bërë në transformimin e të dhënave nga ueb-sajti i mëparshëm, e përkrah faqes Komuna ka arritur të krijojë një infrastrukturë të mirë për të gjithë ata që kërkojnë informacionet e dëshiruara në ueb-sajt.

Është arritur që kategoritë kryesore, si: kuvendi, Kryetari, Financat dhe Prokurimi të jenë të pajisura me të gjitha informacionet e nevojshme.

Përveç faqes zyrtare në internet, komuna është e pranishme me llogarinë e saj në Facebook me një numër të konsiderueshëm ndjekësish, i cili në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitet e komunës dhe Kuvendit. Përmes kësaj platforme qytetarëve i ofrohen informacione në kohë dhe për momentin dhe zhvillimet në komunë.

4.4. Transparenca dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

Në vazhdën e objektivave për transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në vendimmarrje, Kuvendi i Komunës ka miratuar Rregulloren komunale për transparencë me qëllimin që ta harmonizojë atë me ndryshimet më të fundit në *Udhëzimin Administrativ të MAPAA-në 04/2018 mbi Transparencën e Komunave*. Ky veprim është pasuar me hartimin e *Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë 2023-2026*, si një dokument i rendesishëm për sigurimin e një transparence sa më të plotë dhe në përputhje kërkesat ligjore dhe rregulloret.

Komuna mban edhe takime me qytetarë në formë të debateve publike, si dhe bashkëpunon me qytetarët si partner për realizimin e projekteve më interes të përgjithshëm. Në këtë drejtim, rekomandohet Komunës për vitet në vijim është që përmbajtjen e informacioneve dhe mesazheve t'ia adaptojë *nëjtës specifike të platformave për komunikim social.*

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes komunale mbetet një sfidë për t'u adresuar në mënyrë, sipas nënves zbatimit të plotë të *Planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026*

adhur edhe përmes aplikimit të metodave inovative në përputhje me Dumeaken e MAPL-së për Standardet Minimale për Takime Publike.

4.5. Promovimi dhe marketingu i komunës

Komuna e Junikut vazhdimisht po mundohet të bëjë promovimin e aseteve të saj zhvillimore. Në vitin 2023 ka filluar procedurat e prokurimit për prodhimin e materialeve promovuese me qëllim të promovimit të aseteve turistike, natyrore, kulturore dhe historike për qëllim të zhvillimit ekonomik lokal. Postimi i broshurave të reklamës dhe krijimi i platformës https://junikkosove.com.

Në vitet në vijim, Komuna do të sigurohet që kjo platformë të jetë e qëndrueshme, të pasurohet me vazhdimësi në përmbajtje që të shërbejë si burim i besueshëm për të gjithë të interesuarit që duan të vizitojnë Junikun apo që janë të interesuar të vënë kontakte biznesi me aktorët vendorë.

4.6. Vlerësimi vetjak - Analiza SWOT

PËRPARËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT	DOBËSITË AKTUALE TË KOMUNIKIMIT
• Praktikat pozitive të komunikimit të brendshëm	• Interesimi në zbatimin i mediave me frekuencë kombëtare për të ndjekur ngjarje të nivelit lokal
• Kolegjialitet dhe shfrehje profesionale të zyrtarëve për të ndërmarë masurbe të qarta dhe koncize	• Menaxhimi e dhënë e qytetarëve mbi bezeatandërimet e bëjmeve që plasohen nga mediat online (portalet)
• Nisma pozitive në promovimin e komunës dhe aseteve zhvillimore	• Mungesa e një strategjie komunale për marketingun e komunës
• Marrëdhënieri e shëndetshta me përfaqësuesit e mediave dhe OSQ-ve	• Mungesa e mediave audiovizuele me frekuencë lokale
• Vetëdijesimi në rritje i stafit të administratës komunale mbi rëndësinë e komunikimit efektiv	

MUNDËSITË PËR RRITJE TË EFIKASITETIT

- Sektori i kapaciteteve njerëzore në Zyrën për Komunikim dhe Informim
- Teknologji bashkëkohore të qeshme për të realizuar video promocionale me kosto të ulët
- Përdorimi aktiv i teknologjisë në rritjen e efikasitet në komunikim me audiencat (grupet profesionale, OJQ-të, institucionet akademike, etj.)
- Krijimi identitetit vizual të komunës dhe përcaktimi (vizioni, slogani, mesazhet promovuese, etj.) që funksion të arrijnë të objektivave të komunikimit.

RREZIQET E MUNDSHME

- Mundësitë e kufizuara financiare të komunës për të mbështetur një plan intensiv komunikimi
- Tendenca në rritje e qytetarëve që informohen përmes burimeve dhe mediumeve që ofrojnë për pasaktësi dhe mungesë besimi – në kërkim të sensacionit
- Kritika e vazhdueshme e kërkesave për shërbime më cilësore – Kritika e pritjeve

5. PLATFORMA PËR KOMUNIKIM

Komuna e Junikut e ka për obligim që publikun ta informojë mbi prioritetet, politikat, programet, projektet, strategjitë, shërbimet dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për informim dhe komunikim do të mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, bizneseve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe me kosto reciproke. Kjo platformë mbështetet në elementet e mëposhtme:

Transparenca – Me rëndësi të jashtëzakonshme në këtë kontekst është transparenca e ushtrimit me anë të informimit me kohë dhe përmes mjeteve adekuate të komunikimit.

Llogaridhënia – Udhëheqësit e komunës do të mbështeten në parimin e llogaridhënies për punën e tyre karshi qytetarëve të komunës, sidomos në çështjet që ndërlidhen me shpenzimin financiar dhe shpenzimet e komunës.

Përgjegjshmëria – Komunikim i rregullt i autoriteteve komunale me qytetarët që siguron shtalle të larta të përgjegjshmërisë së udhëheqësve përballë premtimeve, suksesave dhe dështimeve eventuale të komunës.

Gjithë përfshirja – Mesazhet e autoriteteve të komunës do arrijnë tek të gjitha komunitetet dhe grupet e interesit me synimin që të sigurohet një informimin i drejtë dhe në kohë i të gjithë qytetarëve: komuniteti të biznesit, komunitetin kulturor, organizatorët të shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit.

Mos diskriminimi – nënkupton informim të drejtë dhe në kohë të të gjithë qytetarëve të komunës pa dallim gjinie, etnie, gjuhe, kulture apo religjioni. Parimi i mos diskriminimit në të njëjtën kohë nënkupton edhe marrjen parasysh dhe adresimin nga ana e komunës së kërkesave të të gjithëve pa asnjë dallim.

Shumëllojshmëria – nënkupton zbërthimin e sa më shumë mjeteve dhe formave të informimit dhe komunikimit duke përfshirë televizionet, radiot, gazetat, portalet elektronike, ueb faqja e komunës, rrjetet sociale, programet aplikacionet specifike të komunës etj.

Informimi me kohë – nënkupton përpjekje të vazhdueshme për informim të koshëm në lidhje me veprimet, aktivitetet dhe planet e saj në mënyrë që qytetarët nga ana e tyre të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me informatën e pranuar.

6. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMIT

Nga sa u dha më sipër, komuna e Junikut synon që në të ardhmen të krijojë personel të mirë-informuar, të respektuar dhe të përkushtuar, të fuqizohet në një institucion të hapur për të përparuar në përshtimeve, të rrisë transparencën, të promovojë ndërveprimin me qytetarët dhe shtetësi të tjerë, të promovojë me saktësi dhe korrektësi aktivitetet dhe punën e saj, si dhe të shtojë dukshmërinë e saj para publikut, qoftë përmes paraqitjeve sistematike në publik qoftë edhe përmes përkrahjes të mediave të rëndë. Arritja e këtij qëllimi kërkon një mekanizëm solid të komunikimi dhe mesazhe të qarta të cilat promovojnë vlerat e punës në administratën komunale, inkurajojnë punën ekipore dhe nxisin ideat inovative.

Duke u nisur nga analiza e gjendjes së përgjithshme në komunikim aktual në komunë, synimet për të avancuar e cila në të ardhmen dhe kapacitetet financiare dhe njerëzore, Komuna e Junikut ka përcaktuar tre (3) objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen permes këtij strategjie:

1. *Avancimi i praktikave të komunikimit të brendshëm në administratën komunale*
2. *Rritja e cilësisë së informimit, transparencës, dhe ndërveprimit me qytetarë*
3. *Promovimi i komunës, aktiviteteve dhe ngjarjeve komunale*

1. *Avancimi i praktikave te komunikimit të brendshëm në administratën komunale*

Komunikimi i strukturuar dhe koherent brenda administratës komunale dhe me audiencat e tjera të brendshme përbën një aspekt vital në përmirësimin e modelit të komunikimit dhe ndërveprimit.

Intervenimet në aspektin e komunikimit të brendshëm do të orientohen në funksion të avancimit të praktikave të bashkëpunimit, raportimit dhe përmirësimit të ambientit të punës me qëllim të rritjes së motivimit në përmirësimin e performancës individuale, ekipore dhe organizative. Komuna do të kryejë intervenimet e duhura për të ndërtuar një kulturë ku të punësuarit në administratën komunale ndjehen mirë dhe kanë besimin e nevojshëm për të shprehur mendimet e tyre në funksion të rritjes së rendimentit të punës dhe efikasitetit të shërbimeve. Një gjë e rëndësishme do të mundësojë qasje të shpejtuar të punonjësit në informacionet e duhura për kryerjen e detyrave të ditëpërditshme dhe punës e ndihmës nga menaxhmenti dhe eprorët (*komunikim nga lart-poshtë*), shkëmbimin ndërsektorial (*komunikim i sektorëve*) dhe do të promovojë një kulturë organizative që promovon dëgjimin e vërtetë të secilit (*nga poshtë-lart*). Komuna e komunikimit të brendshëm të përcaktuara në kuadër të kësaj strategjie do të shërbejnë si komunë udhëheqëse për administratën e komunikimeve dhe do të azhurnohen sipas nevojave dhe në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjik të administratës komunale.

2. *Rritja e cilësisë në informimit, transparencës dhe ndërveprimit me qytetarë*

Sektori përcaktoi kësaj Strategjie edukimin që i promovohet qytetarëve të komunës jo vetëm nga qasja të lehtësuar në informacionet mbi aktivitetet e Komunës, por edhe të mundë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të mundësojë një dinamikë komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë nga shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi. Tutëm kësaj, përmes kësaj strategjie komuna do të mirëmbajë mekanizmin e ligjës të transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të qytetarëve në vendimmarrje (përmes zbatimit të planit të Transparencës 2023-2027), të ndërtojë marrëdhënie të mira me qytetarët, median, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e mbështetësit tonë. Një vëmendje e veçantë do të kushtohet avancimit të komunikimit digjital, sidomos në raport me informimin dhe gjesëndjen aktive të komunitetit në vendimmarrjen komunale.

3. *Promovimi i komunës, aktiviteteve dhe aseteve komunale*

Do të synohet përmes paraqitjeve të strukturuara mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shumë të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rritë praninë e saj në platformat sociale, si një aspekte shtesë ndër të cilësor. Po ashtu, në vitet në vijim të kësaj Strategjie, Komuna do të angazhohet që të hartojë një strategji marketingu në mënyrë që të promovojë vlerat dhe asetet e saj turistike, kulturore dhe historike. Përmes strategjisë së marketingut të komunës do të synohet që të nxisë interesi i vizitorëve, por edhe i investitorëve të mundshëm në të ardhmen.

7. KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe lëvizjen e kësaj Strategjie, Komuna e Junikut do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat e jashtme në mënyrë që aktivitetet, mesazhet dhe projektet e ndërmarra të pasqyrohen me konsistencë dhe të marrin vëmendjen e merituar te publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

